



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Asamble

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 08/2015

Prishtinë, më 10.2.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamt Mustafa, kryetar, Sasha Millosavleviq, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Duda Balje- anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, dhe Fatmir Limaj - anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ilir Saliu, Rexhep Bllaca, dhe Visar Bajraktari - MTI; Lumnije Murati - ZPRK, Dardan Abazi dhe Zanë Hoxha - INDEP, Mimoza Gojani – Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Lejla Selimi - OSBE.

Pjesëmarrës nga mediat: Bujar Tresi - “RTV21”, Bleta Gashi - “RrokumTV”, Arsim Rashiti - “Kosova-Live”, Dona Lluka - “Radio Dukagjini”, Mimoza Sadiku - “Lajmi.net”, Amira Qamil – “Kallxo.com”, Visar Prebreza - “Koha Ditore”, Sylejman Blaku - “Kosova Sot” dhe Elhami Smajli - “Tribuna”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 3.2.2015;
3. Raportim i ministres së Tregtisë dhe Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, me theks të veçantë për ambientin e biznesit dhe nxitjen investimeve;
4. Informate me shkrim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me për tregun e naftës dhe derivatet e saj, strukturën e çmimit, lëvizjen e çmimit dhe sigurimin e cilësisë;

5. Themelimi i Grupit të Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për investimet e huaja;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikës të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 3.2.2015;

Procesverbali nga mbledhja e datës 3.2.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministres së Tregtisë dhe Industrisë, znj. Hykmete Bajrami, me theks të veçantë për ambientin e biznesit dhe nxitjen investimeve;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha së për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe e Industrisë, dhe propozoi që së pari të paraqes raportin me planet që Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë për ambientin e biznesit dhe nxitjen investimeve dhe pastaj të hapim debatin.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, tha se fillimisht falënderoj për ftesën që t'i informojë deputetët për aktivitetet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në lidhje me ambientin e biznesit dhe nxitjen e investimeve dhe po ashtu t'u ofrojë një informatë me shkrim në lidhje me tregun e naftës dhe të derivateve të saj, strukturës së çmimit, lëvizjen e çmimeve dhe sigurimin e cilësisë. Ajo tha se ju, me të drejtë keni ngritur për diskutim dy tema, të cilat edhe janë prioritet strategjik imi dhe i Ministrisë që unë drejtoj. Ajo tha se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka të punësuar rreth 200 persona, të cilët janë nëpunës civilë. MTI-ja, ka një fushëveprim shumë të gjerë dhe përfshinë në kuadër të saj hiq më pak se 6 agjenci, që operojnë për aq sa kanë lejuar kushtet dhe mundësitë, si organe të pavarura dhe 9 departamente. Përveç këtyre, në kuadër të MTI-së ekzistojnë edhe Zyra e Sekretares dhe 3 divizione të tjera, ai i auditimit të brendshëm, i prokurimit dhe i komunikimit publik. Dëshiroj t'ju përkujtoj kolegë të nderuar, që në këtë Ministri janë ndërruar katër ministra brenda një periudhe më pak se dyvjeçare dhe kjo ka bërë që edhe lëvizjet e stafit, sidomos në nivel të udhëheqësve të departamenteve dhe të agjencive të jenë të shumta. Me riorganizimin që kishte filluar në fund të vitit 2012, janë lëvizur nga pozitat e tyre shumë zyrtarë dhe në javët e para të punës sime jam ballafaquar me shumë pakënaqësi të stafit dhe kërkesa për t'u kthyer në pozitat e mëparshme. Më duhet të them që disa prej këtyre zyrtarëve kanë fituar të drejtën e tyre për t'u kthyer në pozitat që i kanë pasur, qoftë përmes vendimeve të gjykatave apo edhe të Këshillit të Pavarur, Mbikëqyrës. Kjo lë të kuptohet që riorganizimi i bërë në MTI, nuk ishte administruar me kujdesin e duhur dhe në raste të caktuara nuk janë respektuar ligjet dhe aktet nënligjore relevante. Deri më tani, unë nuk kam lëvizur qoftë edhe një zyrtar të vetëm nga pozitat e tyre. Ministria ka një buxhet prej më pak se 5,5 milion euro, për 200 mijë € më të vogël se ai i vitit 2014. Nga kjo shumë pothuaj ¼ apo 1,4 milion euro është e destinuar për paga dhe mëditje, rreth 2 milion për mallra dhe shërbime, 1 milion për projekte kapitale (prej të cilave 80% të destinuara për zona ekonomike dhe parqe industriale) dhe 1 milion për subvencione dhe transfere apo thënë më saktë, për implementimin e

Skemës së Garantimit të Kredive, kjo bashkë me donatorët. Siç mund ta kuptoni, MTI ka një Fushëveprimtari shumë të gjerë, por një buxhet shumë modest që është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha obligimeve dhe përgjegjësi të saj. Në kuadër të MTI-së, funksionojnë 6 agjenci, në formë të organeve të pavarura edhe pse jo plotësisht - në mungesë të infrastrukturës dhe burimeve të nevojshme. Agjencia për Përkrahjen e Zhvillimit të Sektorit Privat - e njohur si KIESA- është njëra prej tyre. Kjo agjenci është formuar me bashkimin e dy subjekteve; Agjencisë për Promovim të Investimeve dhe asaj për Përkrahjen e NVM-së. Ajo që mund të them nga informatat e mia gjatë dy muajve të parë në MTI, është që me bashkimin e këtyre dy subjekteve ka pësuar përkrahja për NVM-të. Kam përshtypjen që drejtuesit e agjencisë së re ishin shumë të orientuar për prezantime jashtë Kosovës, por që brenda vendit nuk ishte arritur ndonjë rezultat i lakmueshëm, i cili mund të prezantohej si storie suksesi para investitorëve të jashtëm, tha ministria Bajrami. Statistikat tregojnë që investimet e jashtë FDI, kanë pësuar rënie gjatë viteve të fundit dhe viti 2014, nuk ka qenë një vit i suksesshëm. Investimet e huaja në Kosovë për vitet 2012- 228.7 milionë euro, 2013 258.5 milionë euro dhe viti 2014, për tri kuartalet e para 121.7 milionë euro. Për më tepër, KIESA nuk ka mundur asnjë herë të kompletoj stafin e saj dhe të formuloj një strategji gjithëpërfshirëse, për të përmbushur misionin e saj. Në fund të janarit është dorëhequr edhe drejtori i përgjithshëm i KIESA-s dhe tani kemi filluar procedurat e rekrutimit për emërimin e një drejtori të ri dhe paralelisht na duhet të plotësojmë edhe pozitën e drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Sektorit Privat. MTI ka një përkrahje të rëndësishme nga BE-ja, përmes projekteve të IPA-s, USAID-it, përmes projekteve Partnership for Development dhe projektit Empower, Bankës Botërore dhe IFC-së, Agjencia Zvicerane për Zhvillim SDC, Agjencive dhe organizatave gjermane KfW dhe GIZ, asaj suedeze SIDA, UNDP-së e donatorë të tjerë, që mundësojnë implementimin e shumë projekteve. MTI do të angazhohet fuqishëm në kryerjen e të gjitha obligimeve që i takojnë për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, si intensifikimi i negociatave për shërbimet në kuadër të CEFTA-s; miratimi i Planit të veprimit të strategjisë së Evropës Juglindore 2020; përgatitja e dokumenteve të nevojshme për aplikim për anëtarësim në OBT; arritja e marrëveshjes me qeverinë e Bosnje e Hercegovinës për njohjen reciproke të certifikatave veterinarë, ku kjo marrëveshja për këtë çështje është arritur më 22 janar 2015, pra nga 1 shkurti i vitit 2015, prodhuesit kosovarë mund të fillojnë eksportin e produkteve me origjinë shtazore si dhe të mallrave joushqimore me origjinë shtazore, të cilat i përmbushin standardet relevante sanitare. MTI do të rishikoj infrastrukturën ekzistuese për mbikëqyrjen e tregut të naftës, ku do të iniciohet një projekt i përbashkët me Doganat e Kosovës, me financim të BE-së, për kompletimin e një laboratorit kimik për kontrollin e cilësisë së naftës. Për këtë qëllim, parashihet po ashtu pajisja e Inspektoratit të MTI-së me një laborator mobil. Kontrollimi i të gjitha pikave të shitjes së karburanteve, për t'u siguruar që ato janë të pajisura me licencat e nevojshme dhe do të bëhen kalibrimet e pajisjeve të këtyre pikave nga Agjencia e Metrologjisë. Pikat që nuk posedojnë licencë do të mbyllen nga Inspektorati i MTI-së. Implementimi i platformës për 'inspektime online' – lidhja në mes të sistemit të Inspektoratit të MTI-së dhe Doganave të Kosovës, ë mundëson qasje online për të gjitha mallrat që hyjnë në kufi. Bashkëpunimi me Doganat e Kosovës për bartjen e kompetencave nga trupat për vlerësim të konformiteteve, të cilave nuk do t'u vazhdohet autorizimi. Rasti i parë tashmë ka ndodhur me shfuqizimin e autorizimit të një trupe për vlerësim të konformitetit për sigurinë e lodrave. Do të rishikohet në përgjithësi efektiviteti dhe arsyeshmëria e ekzistimit të trupave inspektuese dhe do të riorganizohet veprimtaria e tyre në bashkëpunim me Doganat e Kosovës. Jemi duke u angazhuar që të riaktivizojmë dhe funksionalizojmë Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili do të shërbejë për dialog të vazhdueshëm mes Qeverisë dhe sektorit privat. Në këtë kuadër do të fuqizohen më tej nëngrupet relevante, ku janë të përfshira drejtpërdrejt bizneset. Organizimi i mbledhjes së parë të Këshillit për këtë vit, në fillim të marsit, në koordinim me ZKM. Sa i përket projekteve kapitale MTI-ja synon funksionalizimin e Qendrës së Skijimit në Brezovicë, dhe do të ndërmarrë veprime të nevojshme, në përputhje me interesat kombëtare dhe ligjet e Kosovës, ku parashihet që Kontrata për koncesionimin e Brezovicës, të nënshkruhet gjatë muajit mars të vitit 2015.

Kryetari i Komisionit, falënderoi znj. Hykmete Bajrami për paraqitjen e raportit të detajuar dhe e inkurajoi që ka nisur një punë të gjerë e të mirë, duke bërë një diagnozë të funksionimit të

deritashëm të MTI-së. Ne sot, tha ai, do t'i shikojmë preokupimit e juve dhe pengesat të cilat ju paraqiten dhe t'i shikojmë detyrat e përbashkëta që i kemi, natyrisht në rolin e komisionit, që ka një rol monitorues të zbatimit të politikave të ligjshmërisë. Ka ardhur koha që sektori privat të gjej vendin e vet, duke i krijuar kushte dhe mundësi për të bërë biznes. Aktivizimi i Këshillit Kombëtar për zhvillim ekonomik, është një lajmi i mirë, pasi që ky këshilli duhet ti koordinoj të gjitha punët dhe do të jetë në shërbim të rritjes ekonomike. Ai tha se është shqetësuese që investimet e jashtme kanë rënë prej vitit në vit, dhe kjo tregon cilësinë e mjedisit jo të mirë që kemi, duke shtuar se të gjitha institucionet duhet të punojnë që ambienti i të bërit biznes duhet të përmirësohet, dhe në përgjithësi krijimi i mjediset biznesor dhe krijimi i një klime më të favorshme për investime, është i lidhur me krijimin e një zinxhiri të përbashkët të të gjitha ministrave, ku tërë Qeveria, Kuvendi dhe Gjykatat duhet të angazhohen për krijimin e ambientit biznesor dhe nxitjen investimeve. Ai më pas paraqiti disa probleme që i kanë disa kompani prodhuese, siç janë: kompania "Fruti" për prodhimin e lëngjeve; prodhuesit e këpucëve; "Bavaria", prodhuesi i sektorit të ndërtimtarisë; "Euflona", prodhues i plastikës, etj, duke thënë se licencat janë problem numër një dhe duhet të luftohet kjo burokraci si dhe mungesa e zbatimit të kontratave, e për këtë duhet të diskutojmë më Këshillin Gjyqësor dhe të gjejmë zgjidhje.

Besimi Beqaj tha se ambienti i biznesit është një temë shumë e gjerë dhe komplekse, që duhet të ketë plan dhe të merren hapa të shpejt nga MTI-ja. Ndërsa për rënien e investimeve të huaja, duhet t'i shikojmë edhe statistikën e vendeve të rajonit dhe të Evropës, sepse më vite të tëra kemi rënie, për shkak të krizës ekonomike botërore, dhe jo vetëm në Kosovë, prandaj në këtë drejtim duhet të jemi syçelë. Sa i përket taksave doganore për lëndën e parë, Beqaj tha se mbi 90% lirohen dhe duhet të ceket saktë për cilat lëndë bëhet fjalë, sepse këto janë të rregulluara me kodin doganor dhe pyeti se cili është plani i juaj si ministre për tërheqjen e investimeve si dhe për projektin e Brezovicës se në çfarë faze është dhe cili është plani i MTI-së për këtë sektor?

Pal Lekaj e falënderoi znj. Bajrami për paraqitjen e raportit dhe planit shumë përmbajtjesorë. Ai pyeti për administratën e MTI-së, se sa zyrtarë janë larguar nga puna nga ish- ministrja e kaluar dhe sa janë kthyer me vendim të Këshillit për Mbikëqyrje të Shërbyesve Civil, dhe me vendim të Gjykatës, ndërsa për zonat ekonomike që janë nëpër komuna, a keni fonde të mjaftueshme për t'i mbështetur? Lekaj shtoi se për qendrën Inovative që ka investuar MTI-ja, të ndërtohet në komunën e Gjakovës, këtu kemi shpëlarje të parës publike dhe konflikt interesi dhe se me këtë çështje po merret edhe Prokurori i Shtetit. Ai theksoi se bizneset po ballafaqohen me kamata shumë të larta nga bankat komerciale, dhe më politikën fiskale nga Administrata Tatimore e Kosovës. Edhe për këto problem MTI-ja duhet të gjejë mekanizmat për të gjetur mënyrën uljes së kamatave dhe të taksave. Për marrëveshjen për tregti të lirë, që është nënshkruar me Turqinë nga MTI-ja, Lekaj tha se në qoftë se fillon të zbatohet, do ta dëmtojë shumë prodhuesin vendor.

Besimi Beqaj sqaroi se Marrëveshja për tregti të lirë me Turqinë ende nuk ka filluar të zbatohet sepse ajo duhet të ratifikohet nga Kuvendi.

Blerim Grainca theksoi se të gjithë treguesit tregojnë që kemi rënie të investimeve dhe top problemi për mosinvestimet e huaja është shkalla e lartë e korrupsionit, dhe problemet dhe procedurat e zvarritjes nëpër gjykata të kontesteve të bizneseve që kanë. Shumë investitorë që kanë ardhur në Kosovë, nuk janë takuar me personat përgjegjës të institucioneve, dhe edhe ky është një problem që ka ndodhur. Ai shtoi se një milion euro të ndara për investime kapitale janë pak, sidomos për zonat industriale dhe ju kisha inkurajuar që takimet me investitorë të huaj t'i keni të drejtpërdrejta e jo në formë të konferencave dhe tryezave. Kërkoj që tregu komercial i bankave të liberalizohet, tha Grainca.

Duda Balje pyeti se a e ka në planin e punës MTI-ja mbrojtjen e prodhuesve vendorë, nëse po cili është ai plan?

Fatmir Rexhepi tha se çështjet që u shtruan nga ana e ministres së MTI-së, ishin të mira dhe kërkesat që varen prej Komisionit dhe Kuvendit, ne jemi të gatshëm që t'i mbështesim. Lidhur më investimet, tha që shtetet e rajonit në krahasim më vendin tonë, po ju ofrojnë kushte shumë më të mira, prandaj, këtu duhet të kemi kujdes më politikat fiskale sepse taksa doganore për materialin riprodhues dhe lëndën e parë është e lartë dhe kjo po i dëmton shumë prodhuesit vendorë, andaj Administrata Tatimore e Kosovës, MTI-ja dhe Ministria e Financave duhet t'i ndryshojnë politikat fiskale për sektorin prodhues, që janë pengesë shumë e madhe për zhvillimin ekonomik të kompanive prodhuese por edhe për vet shtetin. Për marrëveshjen për tregti të lirë që është nënshkruar me Turqinë, Rexhepi tha se është mirë që nuk ka hy në fuqi, sepse e kam cekur edhe një herë se do t'i dëmtonte shumë prodhuesit vendorë. Detyrë e MTI-së është që sektorin privat të biznesit dhe prodhuesit vendorë t'i përkrah dhe t'ju lë hapësirë më të madhe në promovimin e prodhimeve vendore, nëpër panairë që organizohen qoftë vendore dhe ndërkombëtare, tha Rexhepi.

Sala Berisha-Shala tha se sa i përket agjencive, 6 që janë në kuadër të MTI-së, janë shumë dhe kjo ka qenë një dukuri nga e kaluara, ku po thuajse që me çdo ligj që e ka sjell MTI-ja, i kanë parapa këto agjenci, prandaj duhet të shikohet roli i tyre se a janë të nevojshme gjithë këto agjenci. Ajo pyeti për 3 milion të granteve që janë paraparë t'ju jepen ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme se cili është kriteri për ndarjen e granteve dhe a po respektohet kuota gjinore për gratë? Nga kapitali e diasporës, sa është investuar dhe a keni ndonjë statistikë? Çfarë efektesh po kanë panairët që po organizohen në Kosovë? Ndërsa, për investimet e huaja, ajo theksoi se duhet të kemi një analizë më të detajuar me plane konkrete dhe u pajtua me z.Beqaj se duhet të shikohen edhe trendët e vendeve tjera.

Raif Qela, tha se është një ambient i pavoritshëm për bizneset, po pajtohem i gjithë, por jo i gjithë problemi është të MTI-ja sepse për krijimin e kushteve e të bërit biznes, janë edhe institucionet tjera përgjegjëse. Theksoi së mungesa jo mirë e furnizimit më rrymë, konkurrenca jo e lirë dhe moszbatimi i kontrateve, këto janë disa pengesa të mëdha për prodhuesit vendore dhe investitorët e huaja.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, pyeti pse ende Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk i përpunon të dhënat dhe a ka pas MTI-ja takim më këtë agjenci për këtë çështje? A planifikoni të hartoni Strategji për industrinë? Mustafa theksoi se tash 15 vjet nuk i kemi të dhënat statistikore të përpunuara, dhe kjo gjendje na parqet problem për krijimin e kushteve e të bërit biznes dhe për investitorët e jashtëm.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe e Industrisë, ju përgjigj pyetjeve të parashtruara duke thënë se sa i përket strukturës organizative të Ministrisë, këto janë të rregulluara me rregullore të brendshme të Qeverisë, por lidhur më formimin e agjencive ka pas shndërrime nga departamentet në agjenci, që ka pasur për qëllim avancimin e disa individëve. Për zyrën për pronësinë industriale, do të merret vendim sipas ligjit dhe jo sipas rregullores. Për planin e MTI-së, ajo tha se do të jetë parësore përmirësimi i ambientit biznesor. Për projektin e Brezovicës, Bajrami tha se është një ofertë nga konsorciumi francez. Oferta parasheh investime nëpër faza të ndryshme, më një investim prej 410 milionë euro për 20 vite. Komiteti ndërmintor e ka parapëlqyer këtë projekt dhe jemi fazën e negocimit për nënshkrimin e kontratës dhe janë disa kushte që po përgatitën nga të dy palët. Për largimin e punëtorëve nga puna, ajo tha që i kemi gjet disa vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil për kthimin e disa punëtorëve, që duhet t'i zbatojmë, por ka dhe disa lëndë që janë në gjykatë. Për lirin nga kamatat e larta, Bajrami tha se po e shqyrtojmë mundësinë e krijimit të një fondi të caktuar për

disa kategori të bizneseve prodhuese, që t'ju mundësojmë marrjen e kredive me kamata më të ulëta. Për marrëveshjen për tregti të lirë me Turqinë, ministrja Hykmete Bajrami tha se kjo marrëveshje është nënshkruar në Ankara, nga ish-ministrja, znj. Mimoza Kusari-Lila, por që për implementim e saj, duhet miratimi i të dy Kuvendeve, i Turqisë dhe Kosovës dhe se marrëveshja gjendet në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Për mbrojtjen e prodhuesve vendorë, që janë nënshkruar shumë marrëveshje edhe prodhuesit vendorë duhet t'i mbrojmë duke ua hequr taksat doganore dhe TVSH-në. Për grantet, ajo tha se kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në bazë të planit të biznesit dhe të punësimit, ndërsa për mospërpunimin e të dhënave statistikore, Bajrami tha se kjo është një mangësi që po na paraqitet me statistikatat e tregut dhe të produkteve, por për këtë çështje do të kemi bashkëpunim me gjitha autoritetet dhe me doganën. Në fund, ministrja Bajrami tha se ministria që ajo e drejton do të merret drejtpërdrejt me të gjitha problemet që po u shfaqën bizneseve dhe prodhuesve vendorë, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet, aty ku u paraqiten pengesat. KIAS, tha se do të zhvendoset në ZKM. Lidhur me mungesën e energjisë elektrike, Bajrami tha se jemi në kontakt me ministrin Stavileci, për të gjetur zgjidhje.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, e falënderoi ministren për paraqitjen e saj dhe e siguroi atë për mbështetje të vazhdueshme të komisionit që do ta ketë dhe kërkoi ngritjen e kapaciteteve të MTI-së dhe një analizë edhe më të thellë për shkaqet e ngecjes së investimeve.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këto

Konkluzione

- 1. MTI-ja të bëjë analizë për sektorin e prodhimit, problemet në import në pajisje, problemet në importin e materialit riprodhues dhe problemet me eksport si dhe rishikimin e legjislacionit në këto fusha;*
- 2. MTI-ja të hartojë një raport lidhur me Strategjinë e Industrisë;*
- 3. MTI-së i sugjerohet të krijojë fondet e garancive dhe linjat kreditore me Bankën Evropiane të Investimeve dhe Bankën Botërore;*
- 4. Të zhvillohet takim i përbashkët me Komisionin për Legjislacion dhe Këshillin Gjyqësor, për zbatimin e kontratave.*

4. Informate me shkrim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në lidhje me tregun e naftës dhe derivatet e saj, strukturën e çmimit, lëvizjen e çmimit dhe sigurimin e cilësisë;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë pikë kemi kërkuar informatë me shkrim, për shqetësimet që janë shprehur në komision dhe në opinionin publik, lidhur me tregun e naftës dhe derivatet e saj, strukturën e çmimit, lëvizjen e çmimit dhe sigurimin e cilësisë, të informatë të cilën me kohë e ka sjellë MTI-ja. Për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. **Hykmete Bajrami,** ministre e Tregtisë dhe Industrisë, të cilës ia dha fjalën për të paraqitur informatën.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, paraqiti informatën lidhur me për tregun e naftës dhe derivatet e saj, strukturën e çmimit, lëvizjen e çmimit dhe sigurimin e cilësisë. Sa i përket tregut të naftës, MTI-ja në këtë periudhë ka zhvilluar këto aktivitete: Monitorimin dhe analizimin e vazhdueshëm të çmimeve të naftës dhe të derivateve të saj në tregun vendor, rajonal dhe botëror. Kosova aktualisht ka një treg të lirë dhe çmimet e produkteve përcaktohen nga konkurrenca në treg. Pas analizimit të tregjeve rajonale, MTI-ja ka konstatuar se përshtatja e çmimeve të naftës dhe të derivateve të saj në vendin tonë është në suaza të lëvizjes

së çmimeve në tregjet e vendeve të rajonit. Nga krahasimi i çmimeve shitëse me shumicë dhe pakicë, me ato të rajonit, shihet qartë se në Kosovë nuk ekziston mospërshtatje e çmimeve në atë nivel që do ta bëjë të nevojshme ndërhyrjen e Qeverisë së Kosovës për të caktuar çmimin e naftës dhe të derivateve të saj në tregun e Kosovës. Shënimet për strukturën dhe lëvizjet e çmimeve janë dhënë më poshtë në këtë dokument. Fillimi i evidentimit në terren, me pajisje GPS, i të gjitha pikave të shitjes me pakicë të karburanteve, për të evidentuar pikat që janë në funksion dhe ato jashtë funksionit. Deri më tani janë evidentuar 275 pika të shitjes së dizelit, benzinës dhe të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN). Prej tyre, 52 pika (19%) janë jashtë funksionit. Prej 215 pikave të shitjes së dizelit dhe benzinës (pa përfshirë këtu edhe pikat e shitjes së GLN-së), 66% e tyre janë me licenca valide, ndërsa 34% nuk kanë licencë për shitje me pakicë të dizelit dhe të benzinës. Inspektorati i Tregut në MTI, që nga sot do të filloj me mbylljen e pikave që nuk posedojnë licencë valide për operim. Ndërmarrja e aksionit për inspektimin e rrjedhjes (sasisë) së aparateve për mbushje në të gjitha pikat e shitjes me pakicë. Rishikimi i infrastrukturës ekzistuese në tregun e naftës dhe ridefinimi i obligimeve dhe i të drejtave të aktorëve të përfshirë: organeve brenda MTI-së, Doganave të Kosovës, trupave inspektues, laboratorëve, operatorëve, etj. Diskutime me drejtuesit e Doganave të Kosovës, rreth bartjes së përgjegjësisë tek Doganat e Kosovës, për verifikimin e dokumenteve të konformitetit në pikat doganore. Për të realizuar këtë, kërkohet nga Doganat e Kosovës që të shtojnë dhe të trajnojnë stafin, të shtojnë pajisjet laboratorike dhe pajisjet për mostrim, të akreditojnë laboratorin e Doganave të Kosovës për këto shërbime, të bëjnë rregullimin e softuerit për të bërë të mundur qasjen e MTI-së për përzgjedhje të rasteve për mostrime/testime të karburanteve si dhe për numrin e parametrave për testim. Rrjedhimisht, Doganat e Kosovës do të mund të realizojnë në të ardhmen: verifikimin e dokumenteve të konformitetit, të lëshuara jashtë vendit për cilësi të karburanteve dhe mundësisht për përmbushje të kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve. Në fund ministrja Bajrami tha se po diskutohet me Zyrën e BE-së për ridestininim e një fondi mbështetës prej 2 milion euro, që ishte i destinuar për asistencë teknike, për rregullimin dhe mbikëqyrjen më të mirë të tregut të produkteve të naftës, përmes sigurimit të pajisjeve laboratorike për testim, sigurimit të ekspertëve të fushës për vlerësimin e nevojave dhe të infrastrukturës ligjore, si dhe trajnimit të stafit.

Blerim Grainca tha se çështja e tregut të naftës është diskutuar shumë edhe është problematike, prandaj duhet t'i kushtojmë rëndësi më të madhe. Trupat inspektuese janë të obliguar të bëjnë testimin e cilësisë dhe 97% e naftës që hynë në Kosovë është e pakontrolluar, këtë informatë e kam nga kryeinspektori i MTI-së. Në tregun e naftës ka konflikt interesi sa i përket kontrollit të cilësisë dhe leximit të dokumenteve të konformitetit. Grainca pyeti se a ka statistika se sa naftë për prodhime industriale inspekton MTI-ja? Ai tha se zhdoganimet nga dogana bëhen prej tonelatave në litra, këtë pune trupat inspektuese nuk e bëjnë. Për 3 muaj rresht nuk kanë marrë mostrat, ndërsa i lëshojnë certifikatë që nafta është në rregull. Grainca kërkoi nga ministrja që të ushtrojë autoritetin e saj dhe ta sanojë këtë gjendje dhe se të gjitha këto probleme duhet të qartësohen me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit të naftës.

Besim Beqaj tha se trupave inspektuese nuk duhet t'ju lejohet vetëm t'i lexojnë certifikatat, pasi që në këtë mënyrë nuk mund të behët kontrollimi i plotë i naftës, ndërsa për kontrollimin e disa rafinerive vogla të naftës, kjo detyrë nuk duhet t'i lihet Doganës, pasi që po ju merr shumë kohë, për shkak kontrollit të detajuar që duhet t'ju bëhet atyre. Ndërsa, për akreditimin laboratorit të Doganës, Beqaj tha se duhet të bëhet shumë shpejt, në mënyrë që të kontrollohet cilësia e naftës.

Raif Qela tha se zinxhiri i kontrollimit të naftës është negativ dhe jo i mirë, sepse interesi kompanive që merren më këtë veprimtari, është që mos të ketë kontrollim të vazhdueshëm për cilësinë e naftës, ndërsa nafta që po importohet në ripunim, bie ndesh më ligjin për shëndetësi

dhe mjedis. Prandaj, në këtë drejtim, MTI-ja si përgjegjëse kryesore duhet të rritë shkallën e mbikëqyrjes së cilësisë së naftës, përmes angazhimit më të madh të trupave inspektuese.

Pal Lekaj tha që MTI-ja duhet të ketë kontroll më madh sa i përket cilësisë dhe sasisë së naftës, pasi që qytetarët po e vërejnë një mashtrim që po ju behët në pikat e shitjes në sasi. Prandaj MTI-ja duhet ta luftojë këtë dukuri që mos t'i dëmtojë konsumatorët dhe monopolin që është krijuar nga disa kompani.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, ju përgjigj shqetësimeve të ngritura të deputetëve. Për trupat inspektuese, tha që shumë shpejt do ta ketë një marrëveshje kontrolli MTI-ja, më këto kompani të licencuara, për mënyrën se si ta bëjnë kontrollim më efikas për cilësinë dhe sasinë e naftës. Andaj, për këtë do të bëhet një laborator mobil nga MTI-ja, që të bëhen kontrole të rregullta nëpër pikat shitjes dhe në rafineritë që po e përpunojnë naftën dhe për këtë laborator mobil kemi mbështetjen e Komisionit Evropian me 2 milion euro.

Visar Bajraktari, zyrtar i lartë për kontrollimin e naftës në MTI, tha se nga MTI-ja janë licencuar 3 kompani që merren me mbikëqyrjen, cilësinë dhe kontrollin e naftës. Ndërsa sasia naftës që importohet për ripunim nuk është e madhe, sipas të dhënave që ne i kemi nga Dogana.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha që diskutimi ishte shumë përmbajtësor. Sipas informatave, ekziston një konflikt i interesit ndërmjet trupave inspektuese dhe importuesve të karburanteve, dhe se nga kjo dalin të gjitha problemet, për moskontrollimin i mirë të cilësisë dhe sasisë së naftës. Prandaj, për të gjitha këto çështjet që u cekën, duhet të testohen se a janë reale dhe për këto probleme që u ngritën propozoj që të krijohet në task-forcë.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këto

Konkluzione

1. MTI-ja të bëjë analizë për verifikimin e konfliktit të interesit në mes të trupave inspektuese dhe importuesve të naftës;
2. MTI-ja të bëjë analizë lidhur me peshën e naftës dhe testimet në bazë të parametrave ligjor.

5. Themelimi i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për investimet e huaja;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, theksoi se në Planin e Punës për vitin 2015, prej muajit shkurt, kemi paraparë fillimin mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për investimet e huaja. Mustafa kërkoi nga deputetët të formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

V E N D I M

1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja;
2. Grupi punues ka këtë përbërje: Besim Beqaj, kryesues, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Duda Balje, anëtarë;

3. *Grupi punues në bashkëpunim më Njësinë Koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

6. Të ndryshme.

a) Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit lidhur me shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit së Kryesia e Kuvendit, e ka ngarkuar Komisionin që të shqyrtojë shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, lidhur me skadimin e afatit të anëtareve të Bordit të AKP-së

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

Komisioni sugjerojë që të zhvillohen procedurat e nevojshme në Qeveri dhe Kuvend, në një afat sa më të shkurtër të procedohet me propozimet për plotësimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, bazuar në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

b) Kërkesa e Sindikatës MIM Golesh

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me kërkesën që ka ardhur për komisionin, nga Sindikata e MIM Golesh, për shndërrimin të MIM Golesh nga ndërmarrje shoqërore në atë publike.

Për këtë kërkesë, *Komisioni e njofton Sindikatën e MIM Golesh*, se Komisioni, respektivisht Kuvendi, ka në shqyrtim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndërmarrjet publike dhe i rekomandon Sindikatës që në momentin e miratimit të këtij ligji, ti drejtohet Qeverisë dhe organeve përkatëse, për të përmbushur kërkesën e tyre, gjithnjë duke u bazuar në dispozitat dhe të drejtat që ua njeh ligji, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndërmarrjet publike.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa